



Grumbullimi i Kombëtares shqiptare për ndeshjen miqësore Shqipëri-Bjellorusi, e cila do të luhet më 15 nëntor, ora 18:00 (ora jonë lokale) në stadiumin "Akdeniz University Stadium" të Antalias, do të nisë më datë 11 nëntor. Lajmi bëhet i ditur nga Federata Shqiptare e Futbollit. Që të gjithë lojtarët, përfshi këtu edhe stafin teknik, do të udhëtojnë nga vendet e tyre direkt në Turqi, pra nuk do ke të një pikë takimi në Shqipëri dhe më pas udhëtim drejt Antalias. Aty skuadra jonë do të qëndrojë deri më 16 nëntor. Lojtari i fundit që do t'i bashkëngjitet skuadrës pritet të jetë Armando Sadiku, pasi Lugano e tij luan të hënën në mbrëmje ndaj Vil të Gjelbërim Taipit. Ndërkohë, pritet që De Biazi të lere jashtë skuadre mesfushori Ergys Kaçe i cili mund të bashkohet U-21 për dy takimet që do të luhen duke filluar që javën e ardhshme